

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar, Afrim Shala dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.B., nga ..., për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1. të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit, e datës 6 shkurt 2018, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.2048/2017, i datës 11 janar 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 7 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të pandehurit A.B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2048/17, i datës 11 janar 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin A.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me kusht, ashtu që ndaj tij është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është i detyruar i pandehuri A.B., që të dëmtuarës Komunës së Shtimes, në afat prej 6 (gjashhtë) muajve, t'ia lirojë pronën të uzurpuar në mënyrë të paligjshme në sipërfaqe prej 3 (tre) ari, parcela numër P-72809093-00016-1, Zona Kadastrale Shtime, prone shoqërore e pyjeve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në të kundërtën në qoftë se i pandehuri nuk e liron uzurpimin e pronës së

paluajtshme në afatin e dhënë nga gjykata, pas kalimit të afatit do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

E dëmtuara - Komuna e Shtimes, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ka të drejtë që ta ekzekutojë lirim të pronës së uzurpuar në qoftë se në mënyrë vullnetare nuk është liruar prona nga i pandehuri.

Është detyruar i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë Euro), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i pandehuri A.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje ose të lirohet nga kjo akuzë.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/II.nr.430/2018, të datës 27 prill 2018, ka propozuar që të hudhet si e palejuar ankesa e të pandehurit A.B. sa i përket vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa në pjesën tjetër ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatojë se :

- ankesa është e pabazuar.

Siç është theksuar edhe më lartë, i pandehuri A.B., ankesën kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë e ka paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal.

Në ankesën e paraqitur, i pandehuri A.B., nuk e ka specifikuar se në çka konkretisht konsistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkeljet e ligjit penal, përveç faktit që e deklaroi se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka kualifikuar veprën penale. Sa i përket këtyre dy bazave ankimore, edhe pse nuk janë specifikuar konkretisht se në çka konsistojnë shkeljet përkatëse ligjore, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtojë aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatojë se aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit. Veprimet e të pandehurit A.B. i përbëjnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i njëjti dhe kualifikimi ligjor të cilën e ka përdorur gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, kështu që edhe pretendimet ankimore në këtë drejtim janë të pabazuara.

Në ankesën e paraqitur, i pandehuri A.B., sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në një mënyrë vetëm tregon për investimet që ka bërë në parcelën kontestuese, arsyet pse e ka ndërtuar shtëpinë në këtë parcelë dhe faktin se në qytezën e Shtimes, veprime të njëjta sikur i pandehuri, kanë bërë mbi 600 persona, të cilët në mënyrë të njëjtë kanë uzurpuar tokën e Agjencionit Pyjor të Kosovës. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se të njëjtat janë irelevante dhe të njëjtat nuk mund të jenë objekt i vlerësimit të kësaj Gjykate, duke u bazuar në nenin 383 paragrafi 2 të KPP, për shkak se i pandehuri A.B., gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, të datës 11 janar 2018, e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Meqë i pandehuri A.B., ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, mirëpo, nuk ka paraqitur ankesë për shkak të vendimit për dënimin, atëherë, duke u bazuar në nenin 396 të KPP, kjo ankesë përfshin edhe ankesën kundër vendimit për dënimin. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe faktin se është paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, mirëpo nuk është paraqitur ankesë për shkak të vendimit mbi dënimin, atëherë Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare e shqyrtojë edhe sa i përket vendimit për dënimin.

Lidhur me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të pandehurit A.B. është në harmoni me peshën e veprës penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimin të parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.422/2018, Më 7 qershor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Hashim Çollaku

Biljana Rexhiq